

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6090  
E martë, 18 gusht 2020  
çmimi 0.40 €

Po bëhen përgatitjet  
për organizimin e  
mësimit nga 1 shtatori

FAQE 4-5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BASHKIM RAMOSAJ | FAQE 4-5

## LIGJET QË NDALOJNË RRUGËN DEÇAN - PLAVË JANË DISKRIMINUESE



Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se ligjet që ndalojnë ndërtimin e rrugës Deçan - Plavë janë të padrejta dhe diskriminuese për qytetarët e kësaj

komune. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se institucionet qendrore duhet ta ndreqin këtë padrejtësi. Ramosaj ka treguar se kjo rrugë është e një

rëndësie të veçantë për mirëqenien e qytetarëve të Deçanit dhe për zhvillimin ekonomik të kësaj komune. Ai ka deklaruar se punimet në këtë rrugë do të vazhdojnë

## NËNTË TË VDEKUR, 152 TË SHËRUAR DHE 129 RASTE TË REJA ME COVID



AMRI I ANÇA PËR

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur nëntë persona si pasojë e Covid-19, duke e çuar numrin e përgjithshëm të vdekjeve në 410.

Sipas këtij instituti, gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 152 persona dhe janë paraqitur 129 raste të reja me Covid. Ndërsa QKUK-ja ka njoftuar se 40 pacientë me Covid-19 janë në gjendje të rëndë shëndetësore | FAQE 3

## LSDM DHE BDI, AFËR MARRËVESHJES PËR QEVERINË E RE

FAQE 2

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

18. Aug. 2020.  
16:00  
GMT  
Lincoln Red  
Imps  
FC Prishtina

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### OPINION

RAPORTI I DICK MARTYT  
DHE GJYKATA SPECIALE  
PËR "KRIMET E LUFTËS"  
SË UÇK-së (29) F. 11

Shkruan:  
Kudusi LAMA



### AKTUALE

GJERMANIA PRO  
LIBERALIZIMIT, POR DISA  
VENDE ENDE HEZITOJNË F. 7

UN WOMEN VAZHDON TA  
PËRKRAHË AGK-në F. 6

### EKONOMI

OEAK-U: PROJEKTET  
INFRASTRUKTURE, TË  
RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN  
EKONOMIK TË VENDIT F. 9

KOSOVA MERR KREDI  
NË VLERË 30 MILIONË EURO PËR  
T'I NDIHMUAR NDËRMARRJET  
PUBLIKE F. 9

### KULTURË

MINISTRJA DUMOSHI TAKOI  
KËSHILLIN DREJTUES TË  
BIBLIOTEKËS KOMBËTARE F. 6

### SPORT

PRISHTINA SOT PËRBALLET ME  
LINCOLN RED F. 16

## Japonia përballet me tkurrjen më të madhe ekonomike në histori

TOKIO, 17 GUSHT - Ekonomia e Japonisë është tkurrur me shkallën më të shpejtë në historinë e saj, ndërkohë që lufton pandeminë me koronavirus.

Ekonomia e tretë më e madhe në botë është përballur me ulje të bruto-prodhimit të brendshëm për 7.8 për qind në periudhën prill-qershor në krahasim me çerekun e kaluar. Ky shtet veçse ka qenë duke u përballur me rritje të

ngadalësuar ekonomike edhe para pandemisë. Të dhënat e publikuara të hënën kanë vënë në pah sërish ndikimin e madh që ka pasur koronavirusi në shumicën e ekonomive në botë.

Japonia ka rrëshqitur në recession më herët gjatë këtij viti, pas dy çerekëve të njëpasnjëshëm të tkurrjes ekonomike.

Të dhënat e fundit për periudhën prill-qershor përbëjnë

rënien më të madhe prej kur ka nisur të bëhet krahasimi i të dhënave më 1980, duke tejkaluar edhe parashikimet. Ulja e madhe e konsumit të brendshëm është thënë të ketë qenë arsyeja kyçe e kësaj uljeje, derisa edhe eksporti ka rënë dukshëm për shkak të tregtisë së goditur nga pandemia. Të dhënat e këtij viti flasin për performacën më të keqe të ekonomisë japoneze prej vitit 1955.



## LSDM dhe BDI, afër marrëveshjes për qeverinë e re

SHKUP, 17 GUSHT - Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) ka njoftuar të hënën se është pranë arritjes së marrëveshjes me Lidhjen Social-Demokrate (LSDM) të Zoran Zaevit për formimin e qeverisë së Maqedonisë së Veriut. "Ekipet e BDI-së dhe LSDM-së gjatë fundjavës dhe ditës së hënës kanë punuar intensivisht për krijimin e një marrëveshjeje cilësore, të shpejtë dhe të plotë të koalicionit në ditët e para të afatit të përcaktuar me kushtetutë prej 20-ditësh pas marrjes së mandatit. Në bisedimet e zhvilluara në nivelin e sekretarëve partiakë, është arritur përparim serioz në pothuajse të gjitha çështjet që çojnë në një marrëveshje për qeverinë", thuhet në një komunikatë të BDI-së.



Zyrtarë të kësaj partie njoftojnë se të martën do të mbahet "takimi kryesor mes kryetarëve Ali Ahmeti dhe Zoran Zaev, ku pritet një marrëveshje përfundimtare për një qeveri të

re, të qëndrueshme, të përkushtuar me një mandat katërvjeçar". "Duke pasur parasysh urgjencën dhe nevojën për t'i vënë në veprim institucionet kryesore

në vend, për t'i adresuar sfidat shëndetësore dhe ekonomike që lidhen me Covid-19, në ditët në vijim shpresojmë të vazhdojë seanca konstitutive për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut", thuhet në njoftimin e BDI-së.

Nga partia e Ahmetit nuk bëjnë me dije nëse kanë hequr dorë nga posti i kryeministrit, kërkesë kjo me të cilën ka garuar në zgjedhjet e 15 korrikut.

BDI-ja fillimisht kishte deklaruar se kandidati i saj për kryeministër, Naser Zyberi, do të jetë kushti kryesor i kësaj partie për pjesëmarrje në qeveri, por më vonë, pas zgjedhjeve, kjo parti si prioritet vendosi çështje të

tjera si zbatimin e marrëveshjes me Greqinë për emrin, marrëveshjen për fqinjësi të mirë me Bullgarinë dhe marrëveshjen e Ohrit.

Duke komentuar kërkesën e BDI-së, nga LSDM-ja disa herë kanë deklaruar se kryetari i saj, Zoran Zaev, do të jetë kryeministër i vendit. Ai të premtën e kaluar u nominua kandidat për kryeministër nga presidenti i shtetit, Stevo Pendarovski.

Opozita shqiptare, e përbërë nga Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa, kërkojnë nga BDI-ja që ta përmbushë zotimin e saj për kryeministër shqiptar, në të kundërtën kërkojnë të kalojnë në opozitë. BDI dhe LSDM së bashku kanë 61 vota aq sa nevojitet për formimin e qeverisë së re.

## Partia Demokratike në ShBA, gati për hapje të Konventës Kombëtare

WASHINGTON, 17 GUSHT - Partia Demokratike në Shtetet e Bashkuara pritet ta nisë Konventën Kombëtare, ndonëse pjesën më të madhe në versionin online, që do të kulmojë me nominimin zyrtar të Joe Bidenit si kandidat për ta garuar kundër presidentit amerikan, Donald Trump, në zgjedhjet presidenciale të 3 nëntorit.

Konventa Kombëtare Demokratike, që zgjat katër ditë, ishte planifikuar të niste

në Milluaki, Viskonsin, mirëpo pandemia me koronavirus ka shtyrë përpara planet për organizime online.

Fjalime nga Bideni, e përzgjedhura e tij për pozitën e nënpresidentes Kamala Harris dhe personalitete të tjera të larta në mesin e demokratëve, pritet të transmetohen përgjatë këtyre ditëve. Nata e parë do të nisë me fjalimet e senatorit Bernie Sanders dhe ish-Zonjës së Parë, Michelle Obama.



## Zelanda e Re shtyn zgjedhjet për shkak të koronavirusit

WELLINGTON, 17 GUSHT - Kryeministria e Zelandës së Re, Jacinda Ardern, ka shtyrë zgjedhjet e përgjithshme për një muaj, pas rritjes së numrit të rasteve me koronavirus.

Procesi i votimit ishte planifikuar të zhvillohej më 19 shtator, mirëpo tani do të mbahet më 17 tetor. Ardern ka thënë të hënën se data e re do t'u lejojë partive "për ta plani-



fikuar fushatën mbi rrethanat e krijuara".

Më herët gjatë këtij muaji, ky vend është përballur me rritjen më të madhe të të infektuarve me koronavirus, andaj u

është kthyer masave të izolimit. Si pasojë e një shpërthimi në Auckland javën e kaluar, aktualisht në Zelandën e Re është raportuar për 58 raste aktive me këtë virus.



## 40 pacientë me Covid-19 në gjendje të rëndë shëndetësore

Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet e përgjithshme janë duke u trajtuar 573 pacientë, prej tyre 441 prej të cilëve kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. "Oksigjeno-terapisë i janë nënshtruar 372 persona, derisa 40 pacientë janë në gjendje të rëndë shëndetësore", ka njoftuar QKUK-ja. Në klinikat e QKUK-së janë të hospitalizuar 214 pacientë, 166 të konfirmuar pozitivë, kurse 135 janë me oksigjeno-terapi.

Rënie e lehtë e rasteve të reja me Covid-19 në Republikën e Kosovës

# Nëntë të vdekur, 152 të shëruar dhe 129 raste të reja me Covid


Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur nëntë persona si pasojë e Covid-19, duke e çuar numrin e përgjithshëm të vdekjeve në 410. Sipas këtij instituti, gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 152 persona dhe janë paraqitur 129 raste të reja me Covid. Ndërsa QKUK-ja ka njoftuar se 40 pacientë me Covid-19 janë në gjendje të rëndë shëndetësore

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 17 GUSHT** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 449 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve kanë rezultuar 129 raste pozitive me virusin "Korona".

IKShPK-ja ka bërë me dije se brenda këtyre 24 orëve janë raportuar 9 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. "Numri total i rasteve pozitive është 11 545 raste nga 44 433 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 410 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 152 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të

shëruarve deri më sot është gjithsej 7 343 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 792", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar komunat prej nga janë paraqitur rastet e reja me koronavirus. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 45 raste, komuna Pejë 12 raste, komuna Mitrovicë 9 raste, komuna Vushtri 9 raste, komuna Lipjan 7 raste, komuna Gjilan 6 raste, komuna Ferizaj 5 raste, komuna Gjakovë 5 raste, komuna Skenderaj 5 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Obiliq 3 raste, komuna Viti 3 raste, komuna Istog 3 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Klinë 2 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Fushë Kosovë, Malishevë, Novobërdë dhe Shtime", ka njoftuar ky institut.



## Zëvendëskryeministrja Balaj takohet ambasadorin turk, bisedojnë për pandeminë

Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj, ka takuar të hënën ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar, me të cilin ka biseduar për zhvillimet aktuale politike dhe për situatën pandemike në vend. Në profilin e vet në "Facebook", ajo ka shkruar se bashkërisht kanë diskutuar për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit mes dy vendeve, veçanërisht në aspektin ekonomik.

në takim ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar, me të cilin biseduam për zhvillimet aktuale politike, si dhe për situatën pandemike në vend. Bashkërisht diskutuam për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit mes dy vendeve tona, veçanërisht në aspektin ekonomik. Ambasadorin e falënderova për ndihmën e vazhdueshme që Turqia ka dhënë për Kosovën në të gjitha etapat e

shtetndërtimit, me theks të veçantë për ndihmën në konsolidimin e shtetit të Kosovës dhe njohjen e vendit tonë në arenën ndërkombëtare. Nga ana e tij, ambasadori u shpreh i gatshëm për dinamizim të bashkëpunimit mes dy vendeve tona, si dhe u zotua se Turqia do të vazhdojë ta mbështesë vendin tonë ashtu siç ka bërë deri më tani", ka shkruar Balaj-Halimaj.





Flet për “Epokën e re”, Bashkim Ramosaj

# Ligjet që ndalojnë rrugën Deçan - Plavë janë diskriminuese

Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se ligjet që ndalojnë ndërtimin e rrugës Deçan - Plavë janë të padrejta dhe diskriminuese për qytetarët e kësaj komune. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se institucionet qendrore duhet ta ndreqin këtë padrejtësi. Ramosaj ka treguar se kjo rrugë është e një rëndësie të veçantë për mirëqenien e qytetarëve të Deçanit dhe për zhvillimin ekonomik të kësaj komune. Ai ka deklaruar se punimet në këtë rrugë do të vazhdojnë

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 GUSHT - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka ftuar institucionet e Kosovës që t’i marrin parasysh kërkesat e tij në lidhje me ndërtimin e rrugës Deçan-Plavë. Ai ka thënë se punimet në këtë rrugë do të vazhdojnë dhe ligjet që e pengojnë ndërtimin e kësaj rruge janë të padrejta për qytetarët e Deçanit.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka bërë me dije se punimet në këtë

rrugë do të vazhdojnë. “Këto ligje janë të padrejta dhe diskriminuese për qytetarët e Komunës së Deçanit, sepse nuk mund t’u mohohet 70 mijë qytetarëve të Komunës së Deçanit një e drejtë. Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna jonë i ka 41 167 banorë rezidentë dhe rreth 30 000 banorë që jetojnë në botën e jashtme. Është diskriminuese që këtyre banorëve mos t’u jepet shpresë dhe motiv për të jetuar në këtë qytet”, ka thënë Ramosaj.

Ai ka theksuar se institucionet qendrore duhet ta ndreqin këtë

padrejtësi që e kanë krijuar vetë. “Institucionet është dashur që sa më shpejt të merren seriozisht me kërkesat që unë i kam adresuar përmes letrës së hapur. Pra, të mos na fusin në një rrugë të keqe, që nuk i bën nder askujt në këtë shtet, e sidomos Komunës së Deçanit. Padrejtësinë që e kanë krijuar vetë është mirë ta rregullojnë vetë e jo të abuzojnë me një qytet dhe me të ardhmen e këtij shteti”, është shprehur ai.

Ramosaj ka thënë se institucionet qendrore shumë shpejt duhet ta gjejnë një

zgjidhje për këtë çështje dhe të mos e shtyjnë këtë komunë në një rrugë të keqe, e cila nuk i bën nder askujt në Kosovë. “Ne kemi filluar sot me punime dhe përsëri kemi pasur reagime negative, por jo nga kryeministri. Mirëpo kjo rrugë është e rëndësishme së veçantë për mirëqenien e qytetarëve të Deçanit, për zhvillimin ekonomik të kësaj komune, sepse kjo rrugë do të krijojë qasje në resurset më të mëdha që Komuna e Deçanit ka”, ka thënë Ramosaj.

**“Epoka e re”:** Z. Ramosaj, fillimi i punimeve në rrugën Deçan - Plavë ka nxitur reagime të shumta, ndërsa kryeministri i vendit ka kërkuar pezullimin. Si i keni parë këto reagime?

**Ramosaj:** Para një muaji kemi filluar ta ndërtojmë segmentin prej 5 kilometrave e cila është zonë e veçantë, e rrugës Deçan-Plavë. Mirëpo në momentin që është deklaruar data 2 shtator, ku do të mbahet takimi mes Kosovës dhe Serbisë në

Shtëpinë e Bardhë, ka filluar retorika e njëjtë sikurse më herët. Pra, nuk është hera e parë që unë vihem në këtë pozicion si kryetar komune, përgjatë zhvillimit të punimeve në atë rrugë. Ndërkohë personeli i manastirit ka reaguar tepër ashpër, duke i ftuar ambasadat, kryeministrin dhe komandantin e KFOR-it. Më pas kryeministri ka kërkuar nga unë që të pezullohen këto punime me kusht që ta gjejmë një zgjidhje të përbashkët për ndërtimin e kësaj rruge.

**“Epoka e re”:** Çfarë i keni thënë kryeministrit kur ai ka kërkuar nga ju që t’i pezulloni punimet?

**Ramosaj:** Unë ditën e premte kur jam ftuar nga kryeministri që t’i ndal këto punime, e kam mirëkuptuar atë për shkak të gjendjes në të cilën ndodhet Kosova dhe për shkak të takimit të 2 shtatorit. Kam kërkuar nga kryeministri që të bëjë zgjidhje të shpejtë të mundshme që ditën e hënë të fillojmë punimet, mirëpo nuk është

ftesa për një mbledhje për ta zgjidhur këtë çështje. Ne kemi filluar sot punimet dhe përsëri kemi pasur reagime negative, por jo nga kryeministri. Kjo rrugë është e rëndësishme së veçantë për mirëqenien e qytetarëve të Deçanit dhe për zhvillimin ekonomik të kësaj komune, sepse kjo rrugë do të krijojë qasje në resurset më të mëdha që Komuna e Deçanit ka.

**“Epoka e re”:** Pra, ju prapë i keni filluar punimet?

**Ramosaj:** Po, i kemi filluar përsëri punimet. Deri para pak orëve kemi punuar për shkak të dinamikës së kompanisë. Në dhjetë ditët në vazhdim do të shohim, pra në bazë të konsultimeve që do t’i kemi, edhe do të veprojmë më tutje. Nuk duam të bëjmë ndonjë skandal në këtë situatë në të cilën ndodhet Kosova për hir të situatës politike. Kanë kaluar 20 vjet që ne po merremi me të njëjtën temë dhe shpresa e motivimi i qytetarëve të Deçanit është i humbur për të jetuar në këtë qytet. Po ashtu, kam kërkuar nga Policia e Kosovës, nga KFOR-i dhe mekanizmat e tjerë të sigurisë që të jenë të vëmendshëm dhe të kujdesshëm në këtë periudhë kohore me sigurinë e manastirit, sepse këta dinë të bëjnë skandale edhe vetë, në mënyrë që të na lënë fajtorë edhe neve.

**“Epoka e re”:** Kur thoni se gjatë këtyre dhjetë ditëve do të konsultoheni, a do të thotë se gjatë kësaj kohe do t’i pezulloni punimet?

**Ramosaj:** Punimet do të vazhdojnë, njëkohësisht edhe zgjidhja është mirë të bëhet sa më shpejt.

**“Epoka e re”:** Çfarë zgjidhje mund të ofrohet për këtë rrugë?

**Ramosaj:** Unë i kam dërguar një letër të hapur me 15 pika presidentit të vendit, z. Thaçi, kryetares së Kuvendit, znj. Osmani dhe kryeministrit z. Hoti, të cilën institucionet më të larta të shtetit është dashur ta marrin për bazë në mënyrë që ta bëjnë zgjidhjen e duhur. Mos të harrojmë, jemi duke u përballur me Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, i miratuar më 20 shkurt 2008, tri ditë pas shpalljes së pavarësisë, i cili i ka përjashtuar qytetarët e kësaj komune nga drejta e shfrytëzimit të pasurisë së tyre, pronësisë së tyre. Pastaj ne përballlemi me Ligjin për Parkun Nacional, i cili, po ashtu, i ka përjashtuar qytetarët e Deçanit nga zhvillimi i infrastrukturës në këto pjesë. E mos të flasim edhe për marreveshjen a për ndertimin e Bai-Pasit të vitit 2014, me të cilën ka pajtim që rruga ekzistuese të mos ndertohet duke u bere një rrugë e re e cila nuk prek ne Zonën Veçante të Mbrojtur prej 800ha përreth zones së mbrojtur.

Gjithashtu, kemi të bëjmë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të vitit 2014, ku Manastirit të Deçanit i jepen ne pronesi 24ha toke të ndermarrjeve Apliko dhe Iliria, që në njëfarë mënyre e ngufatin cakun e zhvillimit të Komunës së Deçanit.

**“Epoka e re”:** Duke u bazuar në këto ligje që i përmendet, po vlerësohet se ndërtimi i kësaj rruge është i kundërligjshëm. Pse po vazhdoni në këtë mënyrë ndërtimin e kësaj rruge?

**Ramosaj:** Këto ligje janë të padrejta dhe diskriminuese për qytetarët e Komunës së Deçanit, sepse nuk mund t’u mohohet 70 mijë qytetarëve të Komunës së Deçanit një e drejtë. Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna jonë i ka 41 mijë e 167 banorë rezidentë dhe rreth 30 mijë banorë që jetojnë në botën e jashtme. Është diskriminuese që këtyre banorëve mos t’u jepet shpresë dhe motiv për të jetuar në këtë qytet.

**“Epoka e re”:** A po kërkon nga institucionet qendrore që t’i ndryshojnë këto ligje, në mënyrë që ndërtimi i kësaj rruge të mos jetë në kundërshtim me ligjet në fuqi?

**Ramosaj:** Institucionet është dashur që sa më shpejt të merren seriozisht me kërkesat që unë i kam adresuar përmes letrës së hapur. Pra, të mos na fusin në një

rrugë të keqe, që nuk i bën nder askujt në këtë shtet, e sidomos Komunës së Deçanit. Padrejtësinë që e kanë krijuar vetë, është mirë ta rregullojnë vetë e jo të abuzojnë me një qytet dhe me të ardhmen e këtij shteti.

**“Epoka e re”:** Meqenëse po thoni se po vazhdojnë punimet, a frikësoheni se mund të reagojë KFOR-i dhe t’i ndalojë punimet?

**Ramosaj:** Intervenime mund të ketë nga KFOR-i dhe nga Policia e Kosovës, mirëpo unë shpresoj se nuk do të vijmë deri në atë pikë. Por, megjithatë, kam deklaruar edhe sot, kur bëhet boll, bëhet boll. Më tutje kështu nuk mund të ecim.

**“Epoka e re”:** E përmendet marreveshjen për ndertimin e Bai-Pasit të vitit 2014. Pse nuk po ndertohet rruga sipas kësaj marreveshje?

**Ramosaj:** Rruga që ka nisur në vitin 2014 ka qenë përjashtuese për një rrugë tradicionale, një rrugë historike, një rrugë që me shekuj ka qenë aty. Bai-pasi i 2014-s është rrugë për aventura, është rrugë për njerëz që duan adrenalinë. Ajo rrugë nuk është për qarkullim të mallrave, nuk është për qarkullim të njerëzve. Pra, ajo rrugë është për sporte ekstreme, për njerëz që kërkojnë adrenalinë. Ajo fillon në kuotën 600 metra, vazhdon në kuotën 1800 metra dhe prapë bie në kuotën 700 metra, me gjatësi prej tri kilometrave.

bërë ndonjë reagim në këtë drejtim. Më tepër më ka indinjuar edhe thirrja e presidentit Vuçiq i cili ka kërkuar të ndalen punimet dhe

## Po bëhen përgatitjet për organizimin e mësimit nga 1 shtatori

**EPOKA ERE**

**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 17 GUSHT** - Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, së bashku me zëvendëskryeministrat, kanë diskutuar të hënën me ministrin e Arsimit, Ramë Likaj dhe bashkëpunëtorët e tij, për fillimin e vitit shkollor. Hoti ka bërë me dije se ministri Likaj, me ekspertë të fushës, si dhe në konsultim me komunat, SBASHK-un, Këshillin e Prindërve dhe aktorët e tjerë, është duke finalizuar opsionet për organizimin e mësimit nga data 1 shtator. “Komunat dhe drejtorët e shkollave do të kenë udhëzime të qarta se si duhet të organizohet mësimi varësisht nga kushtet që kanë në shkollat e tyre. Mësimi online do të jetë gjithmonë aktiv. Janë duke u zhvilluar protokolle të veprimit se çfarë masa duhet të ndërmerren në çdo situatë që paraqitet. Do të ndërmerret një fushatë informuese për nxënësit dhe arsimtarët për masat mbrojtëse që duhet të


zbatohen”, ka thënë kryeministri Hoti.

Ai ka theksuar se mësime-hënësit janë duke u trajnuar për mësimin online, si dhe po punohet që të kenë listë rezervë të mësime-hënësve që mund të angazhohen sipas nevojës. “Inspeksioni i arsimit do të jetë në mbështetje të shkollave për t’i udhëzuar për masat që duhen ndërmarrë, por edhe për ta mbikëqyrë zbatimin e atyre masave”, ka deklaruar Hoti.

Të hënën ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka vizituar Komunën e Fushë-Kosovës, të Kaçanikut dhe atë të Hanit të Elezit, ku është takuar me kryetarët e këtyre komunave: Burim Berisha, Besim Ilazi dhe Rufki Suma, si dhe me drejtorët e drejtorive komunale të arsimit në këto komuna.

Në të tri takimet me krerët e komunave është biseduar rreth përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021 dhe për rolin e komunave në këtë drejtim.

Ministri Likaj ka folur për përgatitjet që janë bërë nga ana e



MASH-it dhe komunave për fillimin e vitit të ri shkollor, ndërsa ka përmendur faktin se në udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021, në kushtet e pandemisë Covid-19 janë marrë parasysh vlerësimi i gjendjes dhe udhëzimet e UNESCO-s, UNICEF-it, Bankës Botërore, udhëzuesit e CDC-së, IKShPK-së dhe Ministrisë së

Shëndetësisë. Po ashtu, me këtë rast janë marrë parasysh edhe praktikatat e disa vendeve të BE-së.

Ministri Likaj kërkoi nga kryetarët e komunave që t’i marrin masat e nevojshme dhe të jenë të gatshëm për cilindo skenar të përcaktuar me udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit. Kryetari i Fushë-Kosovës, i

Kaçanikut dhe i Hanit të Elezit u zotuan se nga ana e tyre nuk do të mungojë bashkëpunimi me MASH-in dhe të gjitha institucionet e tjera relevante, në mënyrë që të ketë një fillim të suksesshëm të vitit të ri shkollor dhe në cilindo variant të jetë prioritet ruajtja e shëndetit të nxënësve, mësime-hënësve dhe të gjithë aktorëve të institucioneve edukativo-arsimore.

## Ministrja Dumoshi takoi këshillin drejtues të Bibliotekës Kombëtare

Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, në takim me këshillin drejtues të Bibliotekës Kombëtare ka diskutuar rreth punës, përgjegjësive dhe bashkëpunimit mes MKRS-së dhe BKK-së. Ndër çështjet që u biseduan ishin: forcimi i rrjetit bibliotekar të Kosovës, procesi i digjitalizimit, shpërndarja e librit dhe forcimi i mëtejme i politikave për librin, duke rritur krijimtarinë, cilësinë botuese dhe qarkullimin e librit

Ndër temat që ministrja Dumoshi përmendi ishte dhe themelimi i Qendrës së Librit, si një institucion në nivel kombëtar, i cili do të ketë në përgjegjësi të veta kontrollin e botimeve, aspektin e përkthimit të librit shqip në gjuhë të huaja dhe anasjelltas, ndër shumë përgjegjësi të tjera. Ministrja Dumoshi tha se pret një bashkëpunim me Këshillin Drejtues të BKK-së me qëllim të avancimit të bibliotekarisë në Kosovë. Ajo tha se Këshilli Drejtues është urë lidhëse mes ministrisë dhe institucionit kryesor të bibliotekarisë në Republikën e Kosovës.

Ministrja i njoftoi anëtarët e këshillit me planet dhe veprimet konkrete që MKRS-ja do të ndërmarrë për avancimin e infrastrukturës ligjore dhe fizike të bibliotekave në vendin tonë. Anëtarët e Këshillit Drejtues të BKK-së e falënderuan ministren Vlora Dumoshi për pritjen. Ata shprehën gatishmërinë për të bashkëpunuar konform dispozitave rregulluese që institucionin e bibliotekës ta mbajnë në drejtimin e duhur dhe ta rrisin kapacitetin për promovimin, kultivimin dhe ruajtjen e librit.

**EPOKA ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 GUSHT - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka prituri të hënën në një takim njohës këshillin drejtues të Bibliotekës

Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", në përbërje Osman Gashi, Bejtullah Destani, Bukurije Haliti dhe Feim Hoxha, përfaqësues i MKRS-së. Në këtë takim u diskutua rreth punës, përgjegjësive dhe bashkëpunimit mes MKRS-së

dhe BKK-së. Ndër çështjet që u biseduan ishin: forcimi i rrjetit bibliotekar të Kosovës, procesi i digjitalizimit, shpërndarja e librit dhe forcimi i mëtejme i politikave për librin, duke rritur krijimtarinë, cilësinë botuese dhe qarkullimin e librit.



## UN Women vazhdon ta përkrahë AGK-në



PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Gratë vazhdojnë të jenë të përfaqësuar në një numër shumë të vogël në strukturat vendimmarrëse si në nivelin operacional, atë të menaxhmentit, por edhe në nivele më të larta strategjike si shefe ekzekutive. Fuqizimi i pozitës së gruas në media si dhe përmirësimi i pozitës ekonomike të tyre ishin temat kryesore të cilat u diskutuan gjatë takimit në mes të kryetares së Bordit të AGK-së, Gentiana Begolli-Pustina dhe drejtoreshës së zyrës së UN Women në Kosovë, Vlora Tuzi-Nushi.

Drejtoresha Tuzi-Nushi ka premtuar përkrahje të mëtejme të UN Women për AGK-në, në veçanti kur në pyetje është përmirësimi dhe avancimi i grave në pozita vendimmarrëse në organizatat mediale si dhe mbrojtja e të drejtave të tyre. Edhe këtë vit, sikurse vitin e kaluar, AGK-ja së bashku me UN Women do ta ndajnë çmimin vjetor për fuqizimin e gruas. Ndërkaq, drejtoresha e UN Women, Tuzi-Nushi, shpallosi edhe shumë aktivitete të cilat do të realizohen në bashkëpunim me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës siç janë: gratë dhe pozita e tyre në strukturat

vendimmarrëse në media, trajnime praktike për gazetaret në Kosovë si dhe hulumtime të ndryshme të cilat kanë për qëllim paraqitjen e përfaqësimit të pabarabart të grave dhe vajzave në media. Ishte pajtim i përbashkët që fundviti të jetë kohë kur AGK-ja së bashku me UN Women të fillojnë një cikël të ri trajnimesh dhe ndihmë konkrete për ngritjen e mëtutjeshme profesionale të grave në gazetari, nxjerrjen e statistikave të sakta dhe analizën e këtyre statistikave me një qëllim të përbashkët e që është avancimi i perspektivës gjinore në mediat në Kosovë.

## Haradinaj-Stublla takoi anëtarin e Këshillit të Bashkisë së Nju Jorkut

NJU JORK, 17 GUSHT (ER) - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, në ditën e dytë të vizitës zyrtare në ShBA, është takuar me anëtarin e Këshillit të Bashkisë së Nju Jorkut, shqiptaro-amerikanin Mark Gjonaj.

"Kënaqësi ta takoj në Konsullatën e Kosovës në Nju-Jork anëtarin e Këshillit të Bashkisë së Nju-Jorkut, Mark Gjonaj. E falënderova për përkushtimin e vazhdueshëm të tij dhe komunitetit shqiptaro-amerikan në përpjekjet për fuqizimin dhe unifikimin e interesave

tona kombëtare", ka thënë ministrja Haradinaj-Stublla. Bëhet me dije se gjatë këtij takimi u diskutua për zhvillimet politike në rajon dhe u pajtuan për koordinimin e mëtutjeshëm të veprimeve konstruktive dhe rolin strategjik që duhet ta kenë shqiptarët në këto zhvillime.



# Gjermania pro liberalizimit, por disa vende ende hezitojnë

PRISHTINË, 17 GUSHT - Presidenca gjermane e Bashkimit Evropian dhe Komisioni Evropian mendojnë se Kosova i ka përbushur kriteret për liberalizim të vizave dhe se liberalizimi duhet të ndodhë. Por, nuk kanë përgjigje të prerë se kur do të mund të jetë në rend dite vendimi për këtë në Këshillin e Bashkimit Evropian si dhe a kanë kërkuar disa shtete anëtare ndonjë raport të ri për përbushjen e kriterëve nga ana e Kosovës.

Nga Komisioni Evropian kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë" se sa i përket liberalizimit të vizave "Komisioni Evropian qëndron prapa vlerësimit të dhënë që në korrik të vitit 2018 se Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret".

Në pyetjen se a do të ketë ndonjë raport të ri, ky Komision ka thënë se raporton rregullisht në raportet vjetore të progresit për suksesin e Kosovës në fushat e ndryshme që janë të lidhura edhe me kriteret për liberalizim. Raporti i fundit për këtë ishte ai i vitit 2019 dhe në të komisioni kishte përsëritur vlerësimin se Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret.

Burimet diplomatike në Bruksel kanë thënë se komisioni në vjeshtë, kur do ta nxjerrë paketën e zgjerimit dhe raportet vjetore të progresit për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, në to do ta përfshijë edhe vlerësimin rreth përbushjes së kriterëve për liberalizim vizash nga ana e Kosovës. Në këtë moment, thonë burimet në Bruksel, pritet që komisioni të përsërisë se Kosova vazhdon t'i përbushë kriteret e nevojshme dhe se komisioni e mban rekomandimin që vizat të hiqen për udhëtimin e shtetasve të



Kosovës në vendet e BE-së dhe vendet e tjera të zonës Shengen, të cilat nuk janë anëtare formale të BE-së si: Zvicra, Norvegjia, Islanda dhe Litenstajni.

Nga disa burime diplomatike është dëgjuar se disa shtete të cilat hezitojnë ta mbështesin liberalizimin e vizave për Kosovën - siç është rasti me Francën - kërkojnë një vlerësim të ri për të parë nëse Kosova vazhdon t'i përbushë kushtet apo jo. Këto vende kanë disa vërejtje në fushën e sundimit të ligjit dhe disa shqetësime për numrin e azilkërkuesve nga Kosova, i cili, ndonëse është i vogël, megjithatë ekziston, sidomos në Francë.

Parlamenti Evropian, po ashtu, vazhdon ta mbështesë liberalizimin

e vizave. Për më tepër, shumë deputetë të Parlamentit Evropian i janë drejtuar Presidencës Gjermane që të vendosë në rend dite dhe të sigurojë që edhe për qytetarët e Kosovës të hiqen vizat. Ata kanë rikujtuar se Kosova është vendi i vetëm në rajon që nuk e gëzon këtë të drejtë.

Pengesa e vetme për liberalizim vizash tash qëndron te vendet anëtare të BE-së të cilat, me shumicë të kualifikuar, duhet të vendosin në Këshill.

Burimet zyrtare nga Ministria e Jashtme Gjermane kanë thënë se Gjermania vlerëson përpjekjet e Kosovës në vitet e fundit në mënyrë që të përbushen të gjitha kriteret, sidomos ato që kanë të bëjnë me luftën kundër

krimit të organizuar dhe korrupsionit. Por, të njëjtat burime rikujtojnë se vendimi për këtë duhet të merret në Këshill të Bashkimit Evropian. "Në kuadër të kësaj, Gjermania mbështet Kosovën në rrugën e realizimit të liberalizimit të vizave. Për këtë qëllim tashmë kemi pasur bisedime në nivel ekspertësh mes përfaqësuesve të Kosovës dhe ekspertëve të Ministrive Federale të Jashtme dhe të Brendshme gjermane ku kemi diskutuar të gjitha çështjet e hapura", ka thënë ky burim.

Nga Ministria e Jashtme gjermane kanë rikujtuar edhe një prononcim të ministrit për Çështje Evropiane, Michael Roth, para një muaji, ku ai ka thënë se sa i përket Kosovës, "si

BE duhet të zbatojmë atë që kemi premtuar dhe më në fund të ecim përpara në rrugën e liberalizimit të vizave".

Burimet diplomatike në BE vlerësojnë se ende ka gjasa që liberalizimi i vizave të ndodhë para fundit të këtij viti nëse Gjermania, e cila ka kryesimin e radhës të Presidencës Evropiane, angazhohet më shumë për këtë temë gjatë vjeshtës. Edhe pse është e mundur që të sigurohet shumica e kualifikuar në Këshillin e BE-së, gjithsesi do të ketë përpjekje që të sigurohet heqja e kundërshtimit të Francës dhe Holandës, dy shteteve të cilat deri më tash kanë hezituuar më së shumti për ta mbështetur liberalizimin e vizave për Kosovën.

## MPB-ja, e përkushtuar për funksionalizimin e Ligjit për zyrtarët publikë



PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Agim Veliu, ka pritur të hënën në takim

ministren e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, zëvendësmin-

istrin e Arsimit, Xhavit Rexhaj dhe përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në këtë takim është biseduar për Ligjin e Zyrtarëve Publikë, pas publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, të datës 09.07.2020, me të cilin është shfuqizuar pjesërisht ky ligj, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur në fuqi.

Të gjithë të pranishmit kanë vlerësuar se në këtë fazë në të cilën gjendet administrata publike, është e nevojshme të ndërmerren masa dhe veprime, nga të cilat rrjedhin obligime sa i përket marrëdhënies së punës së kategorive të zyrtarëve publikë, përkatësisht nëpunësve të shërbimeve publike në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe

mirëqenies sociale.

Sipas nenit 75 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, aktet nënligjore përgatiten nga ministria përgjegjëse për shërbimin publik përkatës në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për Administratë Publike (tash MPB) dhe të njëjtat miratohen nga Qeveria e Kosovës.

Në këtë takim është vendosur që të gjithë së bashku do të mobilizohen me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve për hartimin e këtyre akteve që rregullojnë këtë fushë për ta vënë në funksion këtë ligj, me qëllim të plotësimit të nevojave të të gjithë resorëve qeveritarë.

# OEAK-u: Projektet infrastrukturore, të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit



**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 17 GUSHT - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka organizuar një forum virtual me ministrin e Infrastrukturës, Arban Abrashi, gjatë të cilit u diskutuan mundësitë e zhvillimit ekonomik përmes projekteve infrastrukturore të cilat mund ta rrisin cilësinë e jetesës dhe numrin e të punësuarve dhe padyshim ndikojnë pozitivisht në tërheqjen e investitorëve të huaj. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka theksuar rëndësinë që ka Ministria e Infrastrukturës për zhvillimin ekonomik të Kosovës, sidomos gjatë fazës së rimëkëmbjes nga pandemia Covid-19, përmes krijimit të vendeve të punës dhe

efekteve të tjera multiplikative. Ministri Abrashi ka thënë se ministria që ai drejton është e orientuar drejt zhvillimit të mekanizmave që kanë efekt të menjëhershëm agregat në ekonominë e Kosovës në përgjithësi, me theks të veçantë tek investimet kapitale. Sipas tij, Ministria e Infrastrukturës do ta ndihmojë zhvillimin ekonomik, duke investuar në infrastrukturën dhe transportin rrugor dhe ajror, linjat hekurudhore dhe largimin e burokracive që pengojnë zhvillimin e projekteve tashmë të kontraktuara, siç është çështja e shpronësimit.

Ministri Abrashi, gjithashtu, tha se me prioritet po trajtohet zgjerimi i rrugëve dhe ndërtimi i segmenteve për kyçe në autostrada, duke synuar evitimin e mbingarkimit të rrugëve

nacionale. Sipas ministrit Abrashi, ekzistojnë pesë projekte madhore infrastrukturore të cilat do të kishin efekt mjaft pozitiv në ekonominë e vendit, që do të prezantohen në ShBA në shtator. Ai shtoi se këto projekte, në veçanti ai për autostradën Trudë - Merdare - Nish, tashmë kanë tërhequr interesim nga institucione financiare amerikane si dhe nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) dhe do të implementohen në momentin e finalizimit të planit ndërtimor. Sa i përket transportit ajror, ai tha se është bërë kërkesë për uljen prej 30 përqindësh të taksave të Aeroportit të Prishtinës, në mënyrë që ai të jetë konkurrues me aeroportet e tjera të regjionit. Përtej kësaj, Abrashi theksoi se ekziston ideja për

subvencionimet e një përqindjeje të çmimit të biletave për udhëtarë, duke ndikuar kështu në zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë së vendit. Ai potencoi se po trajtohet kërkesa për të lidhur një marrëveshje të mirëkuptimit për stacionimin e aeroplanëve të kompanisë Lufthansa në Aeroportin e Prishtinës, ndërsa theksoi se kërkesa të tilla kanë pranuar edhe nga kompani të tjera ndërkombëtare. Sa iu përket hekurudhave, ministri Abrashi përmendi se për momentin po bisedohet për një lidhje hekurudhore Kosovë - Shqipëri, e cila ka potencial të sjellë të hyra të shumta për buxhetin vendor në një periudhë afatmesme. Ai theks të veçantë i dha përmirësimit të proceseve të transportit rrugor të mallrave, gjë që ishte edhe kërkesë e

përfaqësuesve të bizneseve të Odës Amerikane. Sipas tij, transporti rrugor i mallrave po analizohet dhe është në proces të mbledhjes së informatave, trajtimit të dhënies të lejeve bilaterale dhe ato të transitit për eksport në vende të treta, dhe po punohet që Kosova të anëtarësohet në institucione të huaja relevante që trajtojnë nevojat e transportuesve në mënyrë që të krijohen lehtësira për zhvillimin e veprimtarive të këtij sektori me ndikim mjaft të pozitiv në ekonomi. Gjatë këtij forumi përfaqësuesit e bizneseve anëtare të Odës Ekonomike Amerikane adresuan sfidat me të cilat po ballafaqohen si dhe dhanë rekomandimet e tyre rreth ndryshimeve të cilat duhet të implementohen për të siguruar një infrastrukturë më të mirë.

## Posta e Kosovës, me pullë postare 'Kujdes Covid-19'

PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Posta e Kosovës ka dalë me pullë postare "Kujdes Covid-19" që promovon luftimin e pandemisë. Me këtë rast, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se kjo është mirënjohje e veçantë për të, për Ministrinë e Shëndetësisë, ku punonjësit janë të angazhuar me përkushtim maksimal duke kryer detyrat e përditshme dhe duke realizuar projektet për përmirësimin dhe

avancimin e sistemit të shëndetësisë në Kosovë. "Ky është vlerësim për të gjithë ata që po japin kontribut në luftimin e pandemisë Covid-19. Pulla postare 'Kujdes Covid-19' është edhe si mesazh për ndërgjegjësimin publik për respektimin e rregullave në parandalimin e virusit", ka thënë Zemaj derisa ka pranuar këtë pullë postare nga përfaqësuesit zyrtarë të Postës së Kosovës.



# Kosova merr kredi në vlerë 30 milionë euro për t'i ndihmuar ndërmarrjet publike

Ministria e Financave ka nënshkruar marrëveshje në vlerë prej 30 milionë eurosh me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Kredia e likuiditetit të urgjencës së infrastrukturës vitale”. Kredia është e destinuar për ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 GUSHT - Është nënshkruar marrëveshja në mes të Ministrisë së Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Kredia e likuiditetit të urgjencës së infrastrukturës vitale” në vlerë prej 30 milionë eurosh. Kredia është e destinuar për ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale. Kredia do t'i ndihmojë ndërmarrjet publike që ta kalojnë sa më lehtë periudhën e pandemisë duke marrë parasysh se shumica e tyre kanë pësuar rënie në të hyra deri në 50 për qind si rezultat i pandemisë. “Pasi që vendi po vazhdon të

përballet me pasojat e pandemisë Covid-19, përmes kësaj mbështetjeje Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) do ta sigurojë ofrimin e shërbimeve thelbësore të infrastrukturës. Gjatë kësaj periudhe shumë ofrues të infrastrukturës vitale kanë pësuar një mungesë të përkohshme të të hyrave. Këto vështirësi financiare të krijuara nga pandemia synohet që të adresohen nëpërmjet kësaj mbështetjeje nga BERZh”, është thënë në njoftimin e Ministrisë së Financave.

Sipas këtij njoftimi, kësti i parë deri në 14 milionë euro do t'i sigurohet qeverisë për huazim për ofruesit e infrastrukturës vitale për mbështetje të men-

jehershme emergjente. “Ndërkaq kësti i dytë deri në 16 milionë euro do të përdoret për financim dhe mbështetje të mëtejshme deri në përmirësim të arkëtimit të ofruesve të shërbimeve të infrastrukturës vitale”, është thënë në njoftimin e MF-

së. Më tutje, në njoftimin për media bëhet me dije se mbështetja për infrastrukturën vitale gjatë pandemisë Covid-19 është një nga komponentët kryesor të përgjigjes së BERZh-it ndaj krizës së pandemisë. “Si

përgjigje për këtë situatë të krijuar, në nivel global, Banka ka miratuar një paketë solidariteti në vlerë prej 21 miliardë eurosh në periudhën 2020-21 për ta luftuar ndikimin ekonomik të Covid-19”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Financave.

## Rukiqi kërkon miratimin e Ligjit për rimëkëmbjen ekonomike

Kryetari i Odës Ekonomike i Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka bërë thirrje që sa më parë të miratohet Ligji për rimëkëmbjen ekonomike. Ai ka thënë se ky ligj mundëson që shumë instrumente të Pakos Emergjente të implementohen më shpejt



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 GUSHT - Kryetari i Odës Ekonomike i Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, në një konferencë për media ka kërkuar që sa më shpejt të miratohet Ligji për rimëkëmbjen ekonomike. Ai ka thënë se ky ligj është shumë i domosdoshëm të miratohet në mënyrë që të rritet efikasiteti për menaxhimin e ekonomisë në këtë kohë pandemie. “Ky ligj mundëson që shumë instrumente të Pakos Emergjente të implementohen më shpejt. Nevoja është që të kemi masë monetare në treg dhe që nga fillimi i muajit shtator apo tetor të fillojë së zbatuari Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike”, ka deklaruar ai.

Rukiqi ka folur edhe për tërheqjen e mjeteve nga Trusti, me ç'rast ka thënë se këto mjete do ta rrisin qarkullimin. “Pjesa më e rëndësishme e Ligjit për rimëkëmbje ekonomike është pjesa e qasjes më të lehtë në kredi, gjë që do t'u jepte frymë bizneseve dhe lehtësim të qasjes në kredi për ndërmarrjet private për të mundësuar investime. 100 milionë euro parashihen te kjo masë”, është shprehur Rukiqi. Ai më tutje ka thënë se qeveria duhet të shtojë disa masa që lidhen me efikasitetin e energjisë që, sipas tij, përveç rimëkëmbjes ekonomike, do të ishte hap i mirë edhe për transformim të ekonomisë. Sipas tij, qeveria duhet të investojë edhe në aspektin arsimor, duke shtuar drejtime të reja që dalin si nevojë pas pandemisë.

## Nis faza e tretë e dezinfektimit hapësinor në Gjilan

**GJILAN, 17 GUSHT (ER)** - Komuna e Gjilanit ka nisur të hënën fazën e tretë të dezinfektimit hapësinor për të krijuar një ambient pa insekte të dëmshme dhe pengesë në jetën e qytetarëve të Gjilanit.

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e cila e menaxhon këtë projekt, ka konfirmuar se të gjitha përgatitjet janë bërë për fazën e dytë të dezinfektimit që do të vazhdojë për tri ditë me radhë. Gjatë kohës së dezinfektimit qytetarët lutën që t'i mbajnë dritaret e mbyllura, që mos të futen insektet brenda, sikurse një kujdes i veçantë duhet të kenë edhe bletarët të cilët rekomandohen t'i mbyllin bletët e tyre nga ora 19:30 deri në orën

05:00. Dezinfektimi fillon nga lagjja "Zabeli", përkatësisht nga kolektori, ku zakonisht është burim i mushkonjave dhe insekteve të tjera, për të vazhduar përgjatë lumit Mirusha, në të dy anët e tij, deri në qendër të qytetit, po ashtu do të përfshihet lagjja "Reshat Ymeri", Dheu i Bardhë, Dardania, Arbëria, Bregu i Djegur dhe tërë lagjet e tjera të qytetit.

Këtë vit janë të përfshira edhe zonat rurale ku ka potencial të lartë të zhvillimit të këtyre insekteve, sidomos rreth lumenjve të fshatrave Malishevë, Uglarë, Pogragjë, Dobërcan, Përlepnice, Livoqi i Epërm, Livoqi i Ulët, Cernicë, Lladovë, Zhegër, Llashticë dhe Velekinçë.



## Filloi rregullimi i tri rrugëve në Burim të Malishevës



**MALISHEVË, 17 GUSHT (ER)** - Në kuadër të investimeve në rregullimin e infrastrukturës rrugore në fshatrat e Komunës së Malishevës, të hënën ka filluar hapja dhe rregullimi i tri rrugëve në fshatin Burim, ndërsa në Fshatin e Ri ka përfunduar asfaltimi i të gjitha rrugëve, duke e kompletuar infrastrukturën rrugore në

këtë fshat.

Në fillimin e punimeve në fshatin Burim ishin të pranishëm edhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina dhe anëtari i KK të Malishevës, nga ky fshat, Avdi Morina, të cilët janë takuar edhe banorët e lagjeve ku do të rregullohen rrugët dhe i kanë uruar ata për rrugët e reja.

Po në Fshatin e Ri ka përfunduar asfaltimi i të gjitha rrugëve të cilat kishin filluar të rregullohen ditë më parë. Bëhet fjalë për rreth 800 metra rrugë të cilat janë hapur dhe janë asfaltuar. Këtë fshat, gjithashtu, e ka vizituar drejtori komunal për urbanizëm, Ahmet Morina, i cili ka inspektuar punimet e kryera.

## Arrestohen pesë zyrtarë të komunës së Gjilanit

**GJILAN, 17 GUSHT (ER)** - Janë arrestuar pesë zyrtarë komunalë të Komunës së Gjilanit. Arrestimi i tyre është bërë ngaqë ata, duke keqpërdorur pozitën zyrtare, nuk kishin intervenuar në parandalimin e pandemisë Covid-19 në disa lokale në këtë

komune. Me vendim të prokurorit të dyshuarit janë në mbajtje për 48 orë dhe rasti do të vazhdohet. "Janë arrestuar pesë të dyshuar, dy femra dhe tre meshkuj kosovarë, për shkak të dyshimit se kanë bërë keqpërdorim të detyrës zyrtare duke mos intervenuar në

parandalimin e pandemisë Covid-19 dhe rënë në kundërshtim me vendimin e qeverisë. Me vendim të prokurorit të dyshuarit janë dërguar në mbajtje për 48 orë. Rasti vazhdon të hetohet", thuhet në raportin e Policisë së Kosovës.



## 30 familje skamnore në Suharekë do të bëhen me shtëpi

**SUHAREKË, 17 GUSHT (ER)** - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se në këtë komunë do të ndërtohen 30 shtëpi për familjet skamnore falë memorandumit të bashkëpunimit me Shoqatën Humanitare "Jetimat e Ballkanit". Ai ka thënë se fillimisht me shtëpi të re do të bëhet Gëzim Aliaj nga fshati Matiqevë i Suharekës. "Gëzim Aliaj nga Maqiteva do të bëhet me shtëpi të re. Kjo po realizohet si rezultat i Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar më herët me Shoqatën 'Jetimat e Ballkanit' dhe donatorët e saj. 30 shtëpi do të ndërtohen falë këtij bashkëpunimi", ka treguar kryetari Muharremaj.



## Rreth një kilometër rrugë u asfaltua në Sojevë të Ferizajt

**FERIZAJ, 17 GUSHT (ER)** - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka bërë me dije se në fshatin Sojevë është asfaltuar afër një kilometër rrugë. Ai ka thënë se edhe rrjetin e ujësjellësit do ta instalojnë së shpejti dhe kështu do ta përfundojnë infrastrukturën në të gjitha rrugicat e mbetura në



këtë fshat. Me këtë, Aliu ka theksuar se banorëve të Sojevës po ua lehtësojnë qarkullimin me këtë infrastrukturë.

# RAPORTI I DICK MARTYT DHE GJYKATA SPECIALE PËR 'KRIMET E LUFTËS' SË UÇK-së (29)



**Shkruan: Kudusi LAMA**

Për të qenë i drejtpërdrejtë, me raportin që diktoj krijimin e një gjykate speciale dhe tentimin për ta njoollur historinë më të re të Kosovës, do të merremi imtësisht. Dhe këtë me dy qëllime, së pari, për ta komentuar për çdo paragraf dhe, së dyti, që ta njohin të gjithë lexuesit.

Që në titullimin e këtij raporti është e kuptueshme keqdashja dhe bindja në vërtetësinë e tij, pavarësisht se është një raport informues. Ky raport është titulluar "Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë". Vetëm duke iu referuar këtij titulli unë, po ta kisha të drejtën e referimit logjik, do ta kisha quajtur të paligjshëm raportin dhe autorin e tij, jo ta lejoja ndërmarrjen e hapave të tillë, sa të krijohet një gjykatë speciale për të hetuar ata që çliruan vendin e tyre, me akuzat të paracaktuara dhe të parafabrikuara, që konsiderohen aq të vërteta sa nuk kanë nevojë të hetohen më tej, veçse të dënohen të gjithë luftëtarët.

Në vijim raporti thekson: "Sipas informacioneve të mbledhura, tregues të shumtë konkretë dhe konvergues konfirmojnë se disa serbë, si dhe disa kosovarë shqiptarë janë mbajtur rob në vende të fshehta burgimi që ishin nën kontrollin e UÇK-së në veri të Shqipërisë, dhe u janë nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, për t'u zhdukur më pas përfundimisht. Tregues të shumtë me sa duket vërtetojnë se, në periudhën fill pas përfundimit të konfliktit të armatosur, përpara se forcat ndërkombëtare të merrnin në dorë kontrollin e rajonit dhe të vendosnin rendin e ligjshëm, organe të trupit u janë marrë disa robërve në një klinikë në territorin shqiptar, pranë Fushë-Krujës, për t'u transportuar më pas jashtë shtetit për qëllime transplantimi. Edhe pse disa prova konkrete ka pasur edhe më përpara për ekzistencën e trafikimeve të tilla qysh në fillim të dhjetëvjeçarit, autoritetet ndërkombëtare që ushtronin pushtetin në rajon nuk e panë të nevojshme që të bënin një shqyrtim të thelluar të këtyre rrethanave, apo e bënë atë në mënyrë jo të plotë e

sipërfaqësore".

Që në fillim zotëri Marty duket se tregon, që në raportin e tij do të sjellë diçka, të cilën të tjerët nuk kanë qenë në gjendje ta bëjnë. Dhe për çudi fillimisht bën një akuzë të rëndë për shtetin shqiptar, pasi jep idenë që ky shtet nuk e paska kontrolluar hapësirën e vet, sepse brenda tij mund të krijoheshin vende burgimi të fshehta. Një gjë e tillë nuk është aspak e vërtetë, pasi unë kam qenë aty dhe di mirë gjithë veprimtaritë që janë kryer e njëkohësisht aty kanë qenë gjithë shërbimet e botës dhe gjithë mediat e botës. Jam krejt i sigurt se në atë kohë, po të ishte ajo pasiguri që pretendon zotëri Marty, nuk do të guxonin në qëndronin gazetarët nga e gjithë bota, të cilët kanë pasqyruar me saktësi gjithçka.

Nëse shkohet me mendimin se luftëtarët e UÇK-së kanë qenë jashtë kontrollit përsëri gabohet. Ata kanë qenë shumë të organizuar dhe me një disiplinë të fortë.

Zotëri Marty shprehet: "në periudhën fill pas përfundimit të konfliktit të armatosur, përpara se forcat ndërkombëtare të merrnin në dorë kontrollin e rajonit dhe të vendosnin rendin e ligjshëm, organe të trupit u janë marrë disa robërve në një klinikë në territorin shqiptar, pranë Fushë-Krujës, për t'u transportuar më pas jashtë shtetit për qëllime transplantimi". Po ku e mësoi ky zotëri se forcat ndërkombëtare kanë marrë kontroll në shtetin shqiptar? A vërtetë e beson këtë? Në Shqipëri ka pasur rend, qetësi dhe siguri, sepse në të kundërt do të ishte bërë batërdia me 1 milion njerëz të shpërngulur nga Kosova prej forcave fashiste të Serbisë së Milosheviqit që ky zotëri i shërben, të cilët jetuan për një periudhë të vështirë, por pa u ndodhur asgjë. Më habitin ata që i kanë thënë atij hetuesi se në Shqipëri kanë kontrolluar forcat ndërkombëtare, pasi për atë e kuptoj se një gjë e tillë e shkruan me dëshirë, vetëm të arsyetojë veprën e tij akuzuese, pasi këtë detyrë i kanë vënë padronët serb. A ndoshta ia kanë shkruar krejt raportin dhe ai vetëm e ka deklaruar atë.

Organizatat ndërkombëtare të vendosura në Kosovë u prirën drejt një qasjeje politike pragmatiste, duke menduar se duhej doemos favorizuar stabiliteti afatshkurtër, dhe duke sakrifikuar kështu disa parime të rëndësishme të drejtësisë. Ka qenë i pamjaftueshëm hetimi për lidhjen e anëtarëve të UÇK-së me krime lufte të kryera kundër popullsisë serbe dhe kosovarëve shqiptarë. Ekipi i

prokurorëve dhe hetuesve ndërkombëtarë në gjirin e misionit të EULEX-it, ngarkuar për të ndjekur pretendimet për trajtime çnjerëzore, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me një trafikim të mundshëm organesh, ka bërë përparime, konkretisht ka provuar ekzistencën e vendeve të fshehta të burgimit të UÇK-së në veri të Shqipërisë, ku thuhet se janë kryer trajtime çnjerëzore, madje edhe vrasje.

Çudi që një organizim ndërkombëtar me UNMIK-un, EULEX-in dhe KFOR-in, që ne shqiptarët i kemi konsideruar dhe i konsiderojmë organizata shumë të fuqishme, vjen një zotëri i gjithëditur dhe konstaton se nuk kanë punuar mirë. Duhet patjetër të vinte ai e të "ndriçonte" gjendjen pas një dhjetëvjeçari. Por ajo që më krijon një befasi është fakti se në këtë raport këtyre organizatave u jepet hapësirë kontrolli edhe në Shqipëri, pasi gjithçka sipas autorit të raportit ka ndodhur në veri të Shqipërisë. Në fakt këto organizata kanë bashkëpunim me Shqipërinë, por nuk e kanë nën kontroll atë.

Duhet goditur, pa kurrfarë kompromisi, mosdëshkrimi i autorëve të shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut. Fakti që këto shkelje janë kryer në kuadrin e një konflikti të dhunshëm, nuk mund të përligjë kurrë heqjen dorë nga ndjekja penale e autorëve të akteve të tilla. Nuk mundet dhe nuk duhet të ekzistojë një drejtësi për fitimtarët dhe një tjetër drejtësi për të mundurit.

Më vjen mirë që në këtë raport (kuptohet për interesat e autorit) pranohet se Serbia është e mundur dhe UÇK-ja është fitimtare në këtë luftë, pasi deri tani shumëkush përfshi edhe Serbinë janë përpjekur ta zbehin këtë fitore. Por, zotëria raportues është i shqetësuar se qenka përdorur një standard drejtësie ndryshe për humbësit dhe ndryshe për fitimtarët e luftës. Ama, që këta fitimtarët nuk kanë qenë në pozita të barabarta gjatë luftës me humbësit, këtë ai nuk donë ta marrë në konsideratë. Që ata humbësit kanë masakruar një popull të tërë ditën për diell duke vrarë mbi 12 mijë civilë të të gjitha moshave dhe duke shpërngulur 75 për qind të popullsisë e duke zhdukur mbi 2 mijë shqiptarë, kjo nuk i bën përshtypje fare.

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetet e tjera ndihmuese duhet t'i përcaktojnë EULEX-it një objektiv të qartë dhe t'i japin mbështetjen e nevojshme politike për të luftuar pa kompromis krimin e organizuar, me qëllim që drejtësia të vihet në vend, pa u

prirë kursesit nga ndonjë përfitim politik. Shqipëria dhe administrata kosovare duhet të bashkëpunojnë pa rezervë për hetimet e sotme dhe ato në të ardhmen.

Paragrafë të përgjithshëm si ky më sipër mund të përdoren për të gjitha shtetet e botës, pasi gjithkund ka probleme si në Kosovë. Por shkruesi i raportit nuk shqetësohet për këtë. Shqetësimi i tij qëndron që të ndërtohet një mundësi gjuetie shtrigash kundër ish luftëtarëve të UÇK-së. Direktiva e tij është shumë domethënëse, pasi ai bën paralajmërimin e gjithkujt që mund e do të mbështesë ish luftëtarët e UÇK-së se veprimet bëhen për përfitimet politike. Realisht është shumë i thellë në këto instrumentime, po pse edhe kërcënues, këtë nuk arrij ta kuptoj.

Në rezolutën që është bashkë shoqëruar i raportit është theksuar se "Asambleja Parlamentare u njoh me mjaft shqetësim me njoftimet e ish Kryeprokurores pranë Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (GJPNII), e cila pretendoi se gjatë konfliktit në Kosovë ishin kryer krime të rënda, përfshirë trafikim organesh njerëzore, krime që deri më sot kanë mbetur të pandëshkuara dhe nuk kanë qenë objekt i asnjë hetimi serioz". Gjë që le të kuptohet që në fillim, se në gjithë dokumentet e këtij raporti flitet sikur hetimi ka përfunduar, gjithçka është vërtetuar dhe tani duhet vetëm të lëvizin policët për të arrestuar fajtorët. Është vërtetë e çuditshme se si mund të punohen e pranohen në organe të larta politike dokumente të tilla. Dhe në vijim të bindjes shkruhet: "Gjithnjë sipas ish Kryeprokurores, këto akte ishin kryer nga anëtarë të milicive të "Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës" (UÇK) ndaj shtetasve serbë mbetur në vend në fund të konfliktit të armatosur dhe të cilët ishin zënë robër".

Mua më krijon mjegull edhe një praktikë që ndiqet në përpilimin e këtij raporti dhe të dokumenteve shoqëruese, sepse thuhet: "Sipas informatave të mbledhura nga Asambleja dhe sipas hetimeve penale në proces, shumë tregues konkretë e konvergues konfirmojnë që disa serbë, si dhe disa kosovarë shqiptarë janë mbajtur robër në vende të fshehta burgimi të kontrolluara nga UÇK-së në veri të Shqipërisë dhe i janë nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, deri sa më në fund u zhdukën". Po kush ishin këta njerëz, nga ishin, si quheshin, ku e kanë familjen, me çfarë pune janë marrë, cilët janë ata që i njohin? Për këto nuk

thuhet asgjë, thuajse flitet për veprime imagjinare për të trembur fëmijët.

Megjithatë bën përshtypje se në rezolutë thuhet: "Gjatë fazës vendimtare të konfliktit të armatosur, NATO-ja ndërhyri me anë goditjesh ajrore, ndërkohë që operacionet tokësore drejtoheshin nga UÇK-ja, aleate faktike e forcave ndërkombëtare. Pas largimit të autoriteteve serbe, aktorët ndërkombëtarë të ngarkuar me sigurinë në Kosovë u mbështetën gjerësisht tek forcat politike në pushtet në Kosovë, të dala kryesisht nga kadro të UÇK-së". Gjë që mbështetet në të vërtetë. Por brenda vetë dokumentit ka kontradiktë, pasi këta luftëtarë të UÇK-së, ose janë kriminelë që kanë zhdukur njerëz, ose janë luftëtarë që mbajtën peshën tokësore të operacioneve luftarake të NATO-s nga ajri.

Në pikën 10 të rezolutës në fjalë thuhet:

"Organizatat ndërkombëtare të vendosura në Kosovë u prirën drejt një qasjeje politike pragmatiste, duke menduar se duhej doemos favorizuar stabiliteti afatshkurtër, dhe duke sakrifikuar kështu parime të rëndësishme të drejtësisë. Për një kohë të gjatë, pak u bë për t'u dhënë përgjigje sinjalizimeve që implikonin anëtarë të UÇK-së në krime kundër popullsisë serbe si dhe kundër kosovarësh shqiptarë. Në fakt, menjëherë pas përfundimit të konfliktit, kur UÇK-ja kishte praktikisht e vetme kontrollin në terren, u kryen shumë larje hesapesh midis tarafesh të ndryshme dhe ndaj atyre që konsideroheshin, pa asnjë formë procesi gjyqësor, si tradhtarë, sepse dyshoheshin se kishin bashkëpunuar më parë me autoritetet serbe në vend". Duket sikur shqetësimi është thjeshtë pse UÇK-ja e kishte kontrollin e Kosovës pas përfundimit të luftës dhe pikërisht për këtë kjo periudhë duhet të konsiderohet periudhë kriminale. Po pse kush dëshironin shkruesit e rezolutës ta kishte kontrollin?

Dhe në vijim lexoni se sa keqdashës është shkruesi i kësaj rezolute: "Emocioni që ngjallën në rrafsh botëror krimet e llahtarshme të bëra nga forcat serbe krijoi një atmosferë të tillë, që mund të vihej re edhe në qëndrimin e disa instancave ndërkombëtare, duke u mbështetur në mendësinë se disa konsideroheshin doemos si xhelatë, dhe të tjerët si viktima, pra pashmangshmërisht të pafajshëm. Realiteti është më i nuancuar e kompleks". A e kuptojnë lexuesit poshtërsinë e shkruesit me tendencën për të barazuar shqiptarët e masakruar me serbët masakruar? (Vijon)

**E rrallë**

# Pentagoni krijon divizionin për t'i studiuar UFO-t

Mediat amerikane raportojnë se kohët e fundit Pentagoni ka krijuar një divizion të veçantë me detyrë kryesore studimin e UFO-ve. Qëllimi i deklaruar është të "kuptohet dhe njihet më mirë natyra dhe origjina" e fenomeneve në lidhje me objektet fluturuese të paidentifikuara. "Divizioni synon të identifikojë, analizojë dhe katalogojë fenomenet ajrore të paidentifikuara që mund të përbëjnë një kërcënim për sigurinë kombëtare të Shteteve të Bashkuara", ka shpjeguar Pentagoni.



## BARSOLETA E DITËS



**Biondja e zgjuar**  
 - Në cilin trup qjellor ke dëshirë të shkosh?  
 - Biondja përgjigjet: Ne diell!  
 - Në diell? Po nuk e di ti se sa të afroresh atje do të digjesh e shkrihesh nga nxehtësia?  
 - Pse budallaqe jam unë, sigurisht që atje do të shkojë natën!



**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**



**FOTO E DITES**



Monumenti NEWBORN bëhet me bazament

E jashtëzakonshme

# Akulli i Detit Arktik mund të zhduket në tërësi në 2035-n

**A**kulli i detit Arktik mund të zhduket deri në vitin 2035, paralajmëron një studim. Akademikët përdorin një modelimi të klimës të krijuar nga Zyra Met për të zbuluar se si Arktiku u përgjigj gjatë një periudhe ngrohjeje 127 000 vjet më parë. Këto rezultate his-

torike u përdorën më pas për të krijuar parashikime për të ardhmen dhe për të zbuluar se ka të ngjarë të mos ketë akull deti në Arktik pas 15 vjetësh. Fajtori, sipas hulumtimit, është dielli i fortë i pranverës që krijon pellgje me ujë, që thithin nxehtësinë nga dielli dhe më pas kontribuojnë në shkri-

 <p><b>DASHI</b> Yjet në dy ditët e para të javës do ta vënë në qendër të vëmendjes sektorin e mallrave materiale, lehtësojnë suksesin në profesion dhe në menaxhimin financiar.</p>	 <p><b>DEMI</b> Më mirë të jesh i kujdesshëm, veçanërisht me fjalët dhe takime e fshehta dhe hidhërimet ndaj një personi tjetër që nuk është partneri juaj zyrtar.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Dita e sotme do të jetë më e përshtatshme për meditim sesa për veprim. Yjet do t'ju bëjnë të keni një ditë të mbushura me ndjesi të bukura.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Dy ditët e para të javës do të jeni më të hapur për të tjerët dhe në të njëjtën kohë më rezistent dhe të sigurt kur duhet të shpreheni.</p>	 <p><b>LUANI</b> Vepra kur të jesh i sigurt për atë që duhet të bësh. Në dashuri, shmangni kritikën fyese: nuk është rasti të prishni një periudhë kaq të bukur!</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Do të jenë ditë konstruktive plot dashuri. Gjëja e rëndësishme është të mos e prisni të pamundurën dhe të mos tregoheni kokëfortë për detajet.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Ngjarjet e ditëve të ardhshme do ta konfirmojnë gatishmërinë tuaj për të ndërmarrë veprime vendimtare që synojnë përmirësimin e jetës suaj.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Flisni me partnerin tuaj për këtë: do të zgjidhni shumë më tepër nga sa mendoni. Momentet e krizës me partnerin tejkalohe me një sens më të madh realiteti.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Trego cilësitë e tua si optimizëm dhe një ndjenjë të fortë drejtësie, që ju duhet tani më shumë se kurrë.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Yjet e ditës së sotme dhe të nesërme premtojnë emocione të mëdha, ndjesi dhe ngjarje në të cilat ju mund t'i shihni të plotësuar dëshirat tuaja më të thella.</p>	 <p><b>UJORI</b> Paqëndrueshmëria emocionale dhe frika që ju mund të ndieni do t'ju bëjë më pak diplomat dhe nuk do të dëshironi të dëgjoni.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Mësoni rreth interesave humanitare dhe shpirtërore në mënyrë që t'i ndani me ata në nevojë. Keni nevojë të jeni human dhe bamirës.</p>

## Dua Lipa kujton kohën si refugjate: Prindërit e mi gjithmonë ëndërronin të ktheheshin në Kosovë

**K**ëngëtarja e njohur shqiptare me famë ndërkombëtare, Dua Lipa, së fundmi ka pushtuar kopertinën e revistës së famshme "W Magazine". Ajo ka dhënë një intervistë për këtë revistë, duke treguar hollësi nga karriera dhe jeta e saj. Mes shumë sukseseve që po shijon këtë vit, nisur nga albumi i saj "Future Nostalgia" që doli në shitje në mars, revista i ka kushtuar Duas edhe një shkrim mbi periudhën kur ajo ishte refugjate në Mbretërinë e Bashkuar. "Në vitin 1992, tri vjet para lindjes së saj, familja e saj u dëbua nga qyteti i lindjes së tyre, Prishtinë, nga forcat



nën drejtimin e presidentit serb Slobodan Milosheviq. Prindërit e mi gjithmonë ëndërronin të ktheheshin në Kosovë", ka thënë Dua Lipa për revistën në fjalë.

## Brenda rezidencës 40 milionë dollarëshe të Jennifer Lopezit



**Ë**shtë e vështirë të mendosh që Jennifer Lopezit është 51-vjeçare. Pamja e saj është rezultat i dhjetëra orëve në palestër, ushqime të larmishme me vitamina e proteina dhe një trajtim bimor i trupit. Mirëpo për t'i realizuar të gjithë këto gjëra nevojiten para dhe ambiente, të cilat

këngëtarja duket se i ka. Si për ta dëshmuar forcën financiare, ajo dhe i fejuari i saj Alex Rodriguez kanë blerë një rezidencë në ishullin Star në Miami, për plot 40 milionë dollarë. Shtëpia luksoze ka dhjetë dhoma gjumi, dymbëdhjetë banja, pishinë të madhe dhe pamje panoramike.



## Chrissy Teigen tregon format e reja pas njoftimit të shtatzënisë

Chrissy Teigen dhe John Legend kanë njoftuar ardhjen e fëmijës së tyre të tretë nëpërmjet një videoje të këngës së re "Wild" të yllit të popit. Barku i top modelueses që rritet duket qartësisht tashmë dhe ka mjaftuar kjo për ta shpërndarë

lajmin, i konfirmuar më pas nga vetë Teigen në "Instagram". Chrissy është fotografuar nga paparacët teksa shëtiste dhe bënte shopping nëpër rrugët e West Hollywood. Modeluesja ka treguar format e saj të reja, duke shfaqur edhe një pamje të re.

## A ka divorc mes Kanye dhe Kimit?



**T**eksa ka bërë publike kandidaturën për president të ShBA-së, Kanye West nuk ngurroi të tregonte detaje nga martesja me Kim Kardashianin. Këngëtari ka thënë se marrëdhënia e tyre nuk ka qenë gjithmonë solide dhe herë pas here ka pasur luhatjet e saj. Në mes të zërave për një divorc të mundshëm dhe për të mos e dërguar martesën drejt një divorci të mund-

shëm, Kanye dhe Kim së bashku me fëmijët u zhvendosën në fundjavë në një udhëtim "magjik". Ata u shpërngulën për disa ditë në kampin luksoz të "Dunton River" në Kolorado, ku një natë qëndrimi në tendë antike e tepër luksoze kushton plot 43 mijë dollarë. Peizazhi i mrekullueshëm i formuar nga vargmale të mëdha dhe të gjitha për t'u eksploruar është e veçanta e këtij vendi.



# Fati mizor i shkrimtares së parë shqiptare: Në 33 vjet izolim punoi si kafshë për një copë bukë

**Ishte viti i ri. 1 janar 1977. Në një dhomë të varfër, në barakën e saj, në një skaj të mjerë të Shqipërisë, i denjë për një vend vuajtjeje internimi, Musine Kokalari është në prag të pensionit, e shkatërruar nga puna dërrmuese, e zhgënjyer nga realiteti ku ishte zhytur atdheu i saj, me plagë të pashlyera të dhimbjeve e humbjeve familjare, e izoluar dhe e rrethuar me spiunë e njerëz të Sigurimit, por me forcën dhe aftësinë për të ngritur përreth vetes botën e saj të përkorë me dritën e diturisë, kulturës dhe mësimëve të shkollës së saj, Rilindjes...**

Gjithë këtë tablo ajo e hedh në ditarin e saj, në bllokun e shënimeve që e ka titulluar "Jeta ime në Rrëshen gjatë 33 vjetëve revolucion". Nga ky ditar, mbesa e Musinesë, Arjeta Kokalari ka zbardhur disa faqe për t'ia prezantuar publikut të gjerë. Shënimet i përkasin pikërisht 1 janarit 1977.

"Këto dorëshkrime janë pjesë nga shënimet e Musine Kokalari, të mbajtura gjatë kohës kur jetonte e internuar dhe e izoluar në Rrëshen", ka thënë Arjeta Kokalari.

**Pjesë nga ditari i Musine Kokalari "Jeta ime në Rrëshen gjatë 33 vjetëve revolucion"**

Nxënësja e Sami Frashërit, në vetemi kanë kaluar afro 33 vjet revolucion. Në odën time të vogël, ballë meje kam vënë fotografinë e iluministit të shquar Sami, të poetit Naim, të patriotit Sotir Kolea, punonjësit të gjuhës shqipe dhe të lëvizjes kombëtare Jani Vreto, të arsimtarit Koto Hoxhi, mendimtarit

Naum Veqilharxhi, të nderuarit De Rada dhe të urtit Aleksander Xhuvani. Në vetminë time nuk jam vetëm. Jetoj me njerëz të nderuar, të ditur, demokratë që kanë punuar për vendin, për mëmëdheun gjer sa mbyllën sytë. Unë jam nxënësja e tyre.

Kam ndjere dhembjen e përçarjes dhe pata pasojat më të dhimbshme në jetën time. Si furtuna me luftë mbriti revolucioni. Me 12 Nëntor gjatë luftes së Tiranës na muarnë dy vëllezër. Dhe i vrane. Pasoja të naivitetit dhe besimit se nga ta nuk vjen gjë e keqe. I vranë pa bërë gjë. Të parat thika mbas shpine.

...33 vjet me radhë, dallgët e revolucionit më goditën pa ndërprerje. Më ndajtën nga të gjithë. Më izoluan. Nga gjiri i familjes më shkëputën përgjithmonë. Lidhjet u dobësuan. Më duket sikur s'kam qenë kurrë midis njerëzve. U ndava nga ambienti kulturor, duke jetuar me njerëz me fytyrë njeriu po më keq se kafsha. Në fqinjësi që kanë krijuar një batak. Në punë që më shfrytezojnë si një kafshë për një copë bukë, sa u detyrova dhe e lashë vetëm një muaj para

pensionit. Më lajmëroi Komiteti Ekzekutiv të veja dhe të kërkoja punë tjetër. Donin që unë të kërkoja punë tjetër....

...Këto ri e mendoj sot në ditën e parë të vitit 1977 në odën time, ballë mesonjësve të mi të nderuar. Isha dhe mbeta nxënësja e tyre. Kështu kaloi një jetë njeriu që dëshironte punën, kulturën, bukurinë e jetës në formimin e njeriut demokrat, modest, të pastër në ndjenja, të thellë në mendime...

1 janar 77. Unë u formova me bindjen e thellë të kulturës humaniste që e lartëson njerinë si individ dhe në mardhënie me të tjerët në shoqëri dhe në punë. U formova në ambientin tim familjar dhe shoqëror me respektin për çdo punë.

Kam qenë brezi i fundit i gjithë trashëgimtarëve të Rilindjes që jetuan në kohën e ngritjes së flamurit në 1912 dhe në rrethanat e trubullta, shqetësuesë të vendit ndoqën në mënyrë individuale rrugën e kulturës kombëtare, laike, demokratike. Unë jam nxënësja e fundit e formuar në atë shkollë, me konceptin e shëndoshë

që atdheu mbrohet me kulturë, me qëndrim parimor për barazimin ekonomik politik të njeriut modest të punës.

Bashkëkohës, që në jetën e shkurtër si njeri i lirë kam ecur krah më krah me brezin e vjetër si Sotir Kolea, Mati Logoreci, Ibrahim Shyti, Aleksandër Xhuvani, Kristaq Cipo, nxënësja e Urani Rumbos, Sevasti Dakës dhe Parashqevi Kyriazit, duke u prirë për të renë në jetën shoqërore, për një jetë të pasur në ndjenja e mendime e punë të njeriut të thjeshtë, si vazhdimësi e gjithë trashëgimisë kulturele popullore të trashëguar brez pas brezi. Krijimtaria ime e shkurtër, pjesërisht e botuar, pjesërisht e humbur u mbështet mbi tabanin kombëtar të shtratit etnik dhe në realitetin objektiv të kushteve të veçanta të zhvillimit të diferencuar...

Edukata time është ajo e shkollës së Rilindjes. Gjithë kolektivi arsimor e ka kryer me nder këtë detyrë në kohën tonë, në kohën që u bë unifikimi i shkollave, sidoqë mungonin tekstet e tj. Unë nuk kam njohur varfërinë,

nuk kam njohur pasurinë. Ne në familjen tonë të gjithë kemi qenë me shkollë, 3 vëllezër dhe unë katër. Të gjithë kemi punuar dhe kemi kërkuar si e si të përhapim kulturë. Ambienti im familjar ka qenë shumë i thjeshtë dhe i kufizuar në mardhëniet orientuese të kohës, në lidhjet farefisnore e tarafe...

...Nuk kam njohur konflikte shoqërore. Kam njohur burgje në familjen time. Më 1924, vëllezërit e mi shkuan bashkë me të tjeret, pavarësisht se u thyen. Ishin profesore të dy. Muntazi, i madhi ishte kryetar i shoqatës Bashkimi në Gjirokastrë. Organizator i footballit. Ai pikuronte mire. Ishte portretist (diletant). Vëllai i dytë vizatonte mirë dhe ai. Merreshin të dy me pirografi dhe kopshtari. Hamiti, me i vogli ishte kryetar i grupit të mandolinistëve, një nga lojtarët më të mirë të tenisit. Ai meresh me akualet. I binte mirë kitarës. Vetë mësoi fizarmonikën. Në Tiranë dhe pianon.

Babai im ishte avokat. Gjyshi im myfti, bëri çmos që të dy djemtë të ishin me shkollë. Dhe xaxhai im i drejtësisë ishte. Djali i tij Salimi, mësues, gjer në Paris shkoi me familjen për të vazhduar akoma më shumë, po të lartën s'mundi ta mbaronte se iu shtuan fëmijët dhe s'pati mundësi...

...Unë trashëgova pasionin e muzikës. Studiova disa vjet pjano. Po emocionohesha shumë. Me 1932 kur vëllai tim ra në burg, une ndjeva një melankoli të madhe, kur veja e shihja midis shokëve të njohur. Dhe atëherë pjanua për mua u bë një torturë. Nuk mundesha

të përqendrohesh dhe heshtja. Më vinte ndër mend kalaja në Gjirokastrë, kur veja dhe shikoja të mbydhur brenda të dy vëllezërit, me dy shokë të tjerë. Më ngjethet mishtë në korridoret e ftohta kur kaloja. Kur dilja jashtë, dridhesha nga një mundim i brendshëm. Dhe nuk mund të gëzohesha. Ky shqetësim më pushtonte dhe në vitin 1932 nuk mund të luaja pjano. Pasioni tim u kthye në stërmundim dhe në një mbyllje në veten time.

Frau Gertruda, një gjermane, u alarmua. Ajo kishte zakon që nxënëset që s'i bënin mirë ushtrimet i qëllonte me një shkop të hollë dhe bërtite. Me mua, pas gjendjes së dëshpëruar time ajo ndjente keqardhje. Kur gaboja, i binte anës së pjanos. Sa pa lot bërtite. Pastaj me mirrte me te mira: "Ma petite pourquoi?" dhe vazhdonte me frengjishten, duke pjetur se ç'më mundonte. Unë dridhesha, më mbusheshin sytë me lotë. Dhe heshtja. Mundoshesha ta kuptoja pse njerëzit duhet të punojnë, të përpiqen fshehtas. Pse të futen në burg, se duan një gjë të drejtë.

Kjo gjendje e nderpreu hovin e parë dhe shpresën e madhe që kishte frau Grtruada që të më bënte një pjaniste të madhe. Dhe mua më pëlqente vizatimi. Në ekspozitat vjetore të shkollës paraqitesha me pamje të trishtuara të natyrës, me kënde të vetmuar, punuar me karbon. Ngjyra e zezë më mbërthente dhe s'më lëshonte.

Në një udhëkryq të një krize ideologjike demokracie u rrita, në mes ta ambientit intelektual të kohës së rinisë time që

mundohej të gjente rrugën për t'ja përmirësuar gjendjen e vajtueshme të popullit, me ndjenja të thella njerëzore.

Lëvizjen e fshehtë revolucionare nuk e kam kuptuar kurrë. Dhe sot që jam ndeshur me revolucionin në çdo aspekt të jetës sime, prapsepapë une mbeta në luftën e hapët politike.

Mendime të çastit më vinë në kokë sa herë që shoh veten, ose rri në odë dhe s'më lexohet. Shikoj me sytë e mendjes dhe peshoj gjithë sa ka ndodhur në jetën time dhe rrotull meje.

Ky revolucion përmbysi çdo gjë që kishim trashëguar nga e kaluara. Vazhdimisht është një luftë shoqërore me njerëz që një çikë ndahen, bien theyejnë hundët. Është një gjyq i pandërprerë që bëhet me të gjallët, me të afërmit, me të njohurit dhe me të vdekurit. Sa njerëz në rrugën e nisur e kanë ndihmuar në kuptimin e vërtetë zhvillimin shoqëror dhe sa prej tyre, në emër të këtij zhvillimi e kanë penguar atë. Mardhënie të ndërlikuara.

Në mendjen time kam menduar vazhdimisht se dobësia e shtresës demokratike që u gjend në kontradiktë të hapur me regjimin e sotmë duhet të kishte ruajtur solidaritetin në dinjitetin personal, duke i bërë ballë punës së krahut, duke punuar në kushte e duke jetuar në mënyrë modeste. Dhe përse valle duhet t'i shmangeshim kësaj rruge kur gjithçka që mendojmë e vepruam nuk e bëmë për ndonjë interes personal. Gjersa na e dhanë punën e krahut pse të trembeshim, duke humbur atë nevojë morale që duhet të na

lehtësonte këto kthesa të rënda në jetën tonë? Duhet të mbanim lidhjet tona. S'kishim asgjë për të humbur më tepër dhe asgjë për të fituar. Pse u shkëputëm?

Unë në hallet e mia, asnjë çast nuk u ndava me mësuesit e jetës që në mes të një realiteti të mërzi-itshëm kam bërë çmos t'i kem pranë, për t'i bërë ballë poshtërsisë së jetës dhe padrejtësisë që më bënë, për të ngrënë një copë bukë. Shkolla e ndritur e Rilindjes nuk duhet të njolloset. Unë jam nxënëse e fundit dhe gjer në fund, gjer në vdekje do të mbetem një demokrate e thjeshtë, një punëtore e thjeshtë e punës së krahut dhe e pendës. Mendimet e errëta, shpirtngushtët, i kanë të radha rezet e dashurisë.

Brezi i jonë është një brez fatkeq. U ndodh midis dy epokave. Midis të kaluarës dhe përmbysjeve të mëdha shoqërore. Me sa kam parë, gjithë ata që dualnë nga radhët e tyre, që rrëshqitën vetë, apo për shkak të prindërve të tyre nuk dalluan një farë dinjiteti. Gjithë shëmtime dhe qëndrime të pahijshme. Ne të shkollës së Rilindjes dhe ata që vinin nga ambiente tradicionale i kemi bërë ballë gjendjes më me urtesë. Dhe kush u mor me informacion, nuk dëftoi një fytyrë kaq të shëmtuar, si bënë këto vajza me hajdutllëk...

(Emer) është tepër e ulët. Dhe kur e ngritën, shpirtin prej matrapazeje nuk diti ta fshihte. Ajo është një e tërbuar. Deformacioni fizik u shpreh në gjithë qenien e saj, në kuptimin moral, psikik. Po ama dhe burri që ia prunë nuk është vetëm një injorant, por dhe kapada. I duket vetja se po na i hedh. Një

gjë di të thotë: Filani është spiun, filani tjetër është i lidhur me sigurimin. E di i shkreti, e sheh që nuk e qasa fare. E kupton se jo vetëm dyshoj po dhe është gesharak...

\*\*\*

Një e vërtetë e hidhur! Sido që kemi qenë vërtet njerëz të mirë, mbaruam shumë keq. U shpartalluam dhe moralisht. Duke rënë në burg si shumica, në vend që t'u shmangeshim në heshtje, t'u linim udhë, shumica u kacafytën me informatorët. U dhamë shkas që duke na zënë në fyt, shumë prej nesh u kthyen vetë në informatorë, me premtimin se do të mërrnin një vend të mirë në jetën e lirë.

Këta nuk janë më të mençur se ne. Vetëm u treguan aq të vendosur, aq të palodhur duke na mbajtur në burg, sa që persekutimi i pandërprerë dhe frika e kazmës varrosi solidaritetin demokratik. Kështu të përçarë na shtrydhën, na shtypën dhe harruam që ne i përkasim një të kaluarë të ndritur demokratike 100 vjeçare.

Por prapë këta, nga gjiri i tyre, megjithëse kanë kaluar 35 vjet pushtet, gjer më sot s'kam parë individualitet të formuar, veç ligësisë.

\*\*\*

I studiova njerëzit e vrazhdë, të paditur në punën e rëndë të ndertimit, jo me romantikën demokratike të dikurshme. Gjithësekush për vete, pa asnjë shenjë solidariteti. Përkundrazi, kush e kush t'ja hedhi duke thënë se unë punoj dhe tjetri s'punon.... /Telegrafi/



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Prishtina sot përballlet me Lincoln Red



Skuadra e Prishtinës të hënën ka mbërritur në Gjibraltari, kurse sot (e martë do të përballlet me Lincoln Red, në ndeshjen parakualifikuese të Evropa Ligës, edicioni 2020/2021. Kapiteni Armend Thaqi ka premtuar se skuadra e Prishtinës do ta japë maksimumin në këtë ndeshje për ta arritur kualifikimin

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 16 GUSHT** - Skuadra fituese e Kupës së Kosovës në futboll, FC Prishtina, ka mbërritur në Gjibraltari të hënën, pas katër orë udhëtimi. Skuadra më e madhe në futbollin e Kosovës sot (e martë) do të përballlet me Lincoln Red nga ora 18:00. "FC Prishtina ka mbërritur në shtetin e Gjibraltarit për ndeshjen parakualifikuese të Evropa Ligës, edicioni 2020/2021, Lincoln Red Imps (Gjibraltari) - F. C. Prishtina (Kosovë), takim ky i cili

zhvillohet më 18.08.2020 me fillim nga ora 18:00 në stadiumin 'Victoria' të Gjibraltarit", thuhet në njoftimin e FC Prishtina.

Më të mbërritur në aeroportin e shtetit të Gjibraltarit, i tërë kontingjenti i skuadrës së Prishtinës, duke përfshirë futbollistët, stafin dhe kryesinë e klubit, iu ka nënshtruar testeve SARS-CoV-2 nga autoritetet vendore, kurse rezultatet e këtyre testeve do të dalin në orët në vazhdim.

Ditë më parë, lidhur me ndeshjen parakualifikuese në Ligën e Evropës, ka

folur kapiteni i "bardhekaltërve", Armend Thaqi. Ky i fundit ka thënë se Prishtina synon kualifikimin në raundin tjetër të kësaj gare mjaft prestigjioze në futboll. "Është hera e tretë që do të udhëtojmë në Gjibraltari. Ndoshta kundërshtari më i vështirë që ka qenë në short. Në të gjitha mënyrat duhet ta tentojmë kualifikimin në raundin e parë. Normalisht, pres kalimin tutje, nuk do të jetë e lehtë, sidomos nëse e kujtojmë vitin e kaluar, por duhet të kualifikohem. Kemi ende kohë për të punuar në këtë fazë përgatitore dhe duhet të jemi sa më të gatshëm", ka thënë Thaqi.

## SHKURT

### Vojvoda do të nënshkruajë marrëveshje pesëvjeçare me Atalantën

Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Mërgim Vojvoda, pritet ta vazhdojë karrierën në elitën e futbollit italian. Eksperti i transferimeve të Serisë A, Nicholo Schira, raporton për një marrëveshje të arritur mes Atalantës dhe Vojvodës. Klubi italian tani i duhet ta finalizojë marrëveshjen me belgët e Standard Liege, me bisedimet që duket të kenë avancuar. Raportohet se skuadra e Serisë A ka rënë dakord ta paguajë shumën prej 6 milionë eurove, të kërkuara nga Liege. Mbrojtësi nga Kosova do të nënshkruajë kontratë pesëvjeçare. Vojvoda është pjesë e Standardit që nga viti 2019, kur ishte transferuar nga Mouscron.

### Munishi: Kosova është dashur të prezantohet në Evropë me Ferrari, jo me traktorë

Trajneri Ismet Munishi mendon se Ballkani do të përfaqësonte më së miri futbollin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ai ka thënë se skuadra nga Suhareka do të ishte "Ferrari" në Evropë. Ndërkohë, sipas Munishit, skuadrat e kualifikuara në Evropë sivjet, Drita, Gjilani dhe Prishtina, janë "traktorë". "Kosova është dashur të prezantohet në Evropë me Ferrari, jo me traktorë", ka deklaruar Munishi në "Kanal10". Munishi iu ka uruar suksese skuadrave vendore në arenën ndërkombëtare. Drita, Gjilani dhe Prishtina do të luajnë në kualifikimet e Ligës së Evropës.

### Chelsea huazon Brojën në Vitesse

Armando Broja ishte një nga zbulimet e Chelseat. Sulmuesi shqiptar bëri debutimin në Premierë Ligë si dhe mori pjesë në Kupën e Anglisë. Broja shpërtheu tek akademja e Chelseat duke zgjuar kështu interesimin e trajnerit Frenk Lampard për ta grumbulluar disa herë me skuadrën e parë. Por me blerjet e reja, sidomos në fazën ofensive, nuk ka vend për momentin për Brojën te Chelsea. Por Lampard nuk dëshiron ta humbasë sulmuesin shqiptar pasi e cilëson lojtar me perspektivë, ndaj dhe ka vendosur ta huazojë te Vitesse në kampionatin holandez. Kujtojmë që Vitesse është klubi simotër i Chelseat pasi ka të njëjtin pronar, Roman Abramovich.

## Tenisti Nishikori infektohet me Covid-19

Tenisti japonez Kei Nishikori ka dalë pozitiv në testin për koronavirus dhe si pasojë nuk do të jetë në gjendje të luajë në turneun Cincinnati Masters. Ai rrezikon të mungojë në grand slamin US Open, i cili nis pas dy javëve. Finalisti i

vitit 2014 në US Open thotë se ndihet mirë dhe se është vetizoluar. Ai njoftoi se do ta bëjë edhe një test tjetër të premtën. Kampionët në fuqi Rafael Nadal dhe Bianca Andreescu kanë njoftuar tashmë se nuk do të marrin pjesë në US Open.

"Këtë mëngjes në Florida e bëra testin për Covid-19 dhe dola pozitiv", ka thënë numri 31 i botës. "Më duhet të tërhiqem nga turneu Cincinnati këtë herë. Unë dhe ekipi im do të testohemi përsëri të premtën", ka shtuar ai.

## Drita, kërkesë të re për UEFA-n

GJILAN, 17 GUSHT - Skuadra kampione e Kosovës, Drita, ka bërë edhe kërkesën e tretë për zhvillimin e ndeshjes ndaj Linfieldit. Feti Murseli, drejtor i klubit nga Gjilani, ka treguar në Klan Kosova tri kërkesat e

Dritës për UEFA-n. "Kërkesa e vetme është që të zhvillohet ndeshja. Neve na është bërë e padrejtë. Vendimi ka qenë subjektiv. Jemi dëmtuar. Autoritetet kanë vendosur të kthehemi në Kosovë",

deklaroi Murseli. "Në momentin e parë kemi kërkuar që ndeshja të zhvillohet pas tri ditësh, por prapë përgjigjja ka qenë e njëjtë. Në kërkesën e dytë kemi kërkuar që ta zhvillojmë ndeshjen me

juniorë që, po ashtu, u refuzua", ka shtuar ai. "Kemi bërë edhe një kërkesë që takimi mes Legias dhe Linfieldit të shtyhet, që ne ta luajmë ndeshjen. Tani jemi në pritje", ka shtuar Murseli.



# Kloppi parashikon finale gjermane në Ligën e Kampionëve

LIVERPOOL, 17 GUSHT - Jurgen Klopp është trajneri fitues i Ligës së Kampionëve për edicionin e fundit. Trajneri gjerman triumfoi këtë vit me Liverpoolin, por nuk arriti të mbetet në garë pasi u eliminua në 1/8 e finales në Ligën e Kampionëve nga Atletico Madridi. Tani kur gara më e madhe evropiane për klube është drejt fundit, Jurgen Klopp ka folur për sfidat gjysmëfinale. "Do të jenë dy ndeshje shumë të zjarra", deklaroi Klopp.

53-vjeçari ka parashikuar edhe finalen e madhe të Ligës së Kampionëve, teksa thotë se i sheh dy ekipet gjermane duke diskutuar trofeun më të çmueshëm evropian për klube. "Një derbi mes Bayernit dhe Leipzigit në finale është më se i mundur. Bayerni është duke kaluar nëpër një formë të jashtëzakonshme, por edhe Leipzig gjithashtu është në formë, pasi ka bërë ndeshje të madhe në çerekfinale ndaj Atletico", ka shtuar Klopp, i cili

pret një finale gjermane në Lisbonë.

Klopp nuk përjashton mundësinë e largimit nga futbolli në vitin e kontratës me Liverpoolin. Strategu 53-vjeçar është i lidhur me "Të Kuqtë" me një kontratë deri në vitin 2024. "Do të marrë një vit pushim dhe më pas më pyesin 'nëse më mungon futbolli'. Nëse jo, do të jetë fundi i Jurgen Kloppit si trajner" ka thënë strategu gjerman në një intervistë për sajtin e njohur "Sportbuzzer".



## Lakersat, fanellë speciale në 'play-off', dedikuar Bryantit

LOS ANXELOS, 17 GUSHT - Nëse skuadra e Lakersave do t'i kalojë rivalët e Portlandit në raundin çerekfinale të "play-off"-it të NBA-së, ka konfirmuar se do ta përdorë në turnet pasardhëse një fanellë të veçantë në kujtim të legjendës Kobe Bryant, i ndarë nga jeta në janar të këtij viti, pas një aksidenti me helikopter. Fanella është dizajnuar kohë më parë nga vetë Bryant, madje është veshur nga skuadra në sezonin 2017-2018. Në këtë fanellë janë stampuar në anën anësore 16 yjet, që përfaqësojnë 16 tituj kampionë në NBA. "Nike" do ta prezantojë fanellën në javën e dedikuar Kobe Bryantit, ku do të zhvillohen disa ngjarje speciale.



### SHKURT

#### Messi ka kërkuar largimin nga Barça

Lionel Messi ia ka bërë të qartë Barcelonës se dëshiron të largohet menjëherë nga klubi, pas dështimit të turpshëm të katalanëve në Ligën e Kampionëve, përballë Bayern Munchenit. Ylli argjentinas bëri një figurë të shëmtuar bashkë me shokët e ekipit teksa u mposhtën thellë 8-2 në Lisbonë, duke pësuar poshtërimin më të madh në histori. Kjo ka bërë që Messi të marrë në konsideratë të ardhmen e tij. Sipas "Esporte Interativo", tani ai kërkon largimin e menjëhershëm, pasi ka mbetur tepër i zhgënjyer nga mënyra sesi është drejtuar klubi. Ai thuhet se ndihet i izoluar pas dështimeve të përsëritura në Ligën e Kampionëve dhe zhgënjimit të fundit në La Liga. Lajmi vjen pasi "Sunday Mirror" zbuloi ekskluzivisht se Manchester City është në "pole" për ta rrëmbyer Messin, nëse ai vendos të largohet nga "Nou Camp". Citizens do t'i paguanin Messit gjithçka që duhet për ta joshur dhe për ta ribashkuar atë me Pep Guardiolen në "Etihad". Interes për 6 herë fituesin e Topit të Artë ka pasur edhe nga Interi, por tashmë zikaltrit duhet të jenë më konkretë, pasi do të kenë një konkurrent të fortë për një nga lojtarët më të mirë të historisë së futbollit.

#### Halep nuk merr pjesë në "US Open"

Tenistja numër dy në botë, Simona Halep, ka vendosur të heqë dorë nga pjesëmarrja në Grand Slamin "US Open". Halep është tenistja e gjashtë nga dhjetë teniste të Top 10 që kanë vendosur të mos marrin pjesë në "US Open", që do të fillojë më 31 gusht, shkaku i pandemisë Covid-19. "Unë gjithmonë kam thënë se do ta vë shëndetin tim para", ka thënë Halep, shkruan BBC. Më herët kanë vendosur të mos marrin pjesë edhe kampionia në fuqi, Bianca Andreescu, tenistja numër një në botë Ashleigh Barty. Po ashtu, nuk do të marrin pjesë edhe ukrainasja Elina Svitolina, holandezja Kiki Bertens dhe zvicerania Belinda Bençiq. "Pasi kam marrë në konsideratë gjithë faktorët dhe rrethanat e jashtëzakonshme në të cilat po jetojmë, kam vendosur të mos udhëtoj", ka thënë Halep.

#### Harti nënshkruan për 'Spurs'


Joe Hart më në fund ka gjetur një skuadër të re. Portieri anglez ka nënshkruar për dy vjet me Tottenham Hotspurin. Hart kishte disa kohë që ishte pa skuadër. 33-vjeçari ka provuar të luajë në Serinë A me Torinon, si dhe në Premier Ligë me disa ekipe angleze. Hart ka qenë për shumë vite portier i parë i Manchester Cityt. 33-vjeçari ka mbrojtur për disa vite edhe portën e kombëtares së Anglisë, ku pjesëmarrja e fundit me Anglinë ishte në Evropianin e 2016-s.

#### Portlandi siguron një vend në 'play-off'

Portlandi është skuadra e fundit që siguron një vend në çerekfinale të "play-off"-it, pas fitores 126-122 ndaj Memphisit, në ndeshjen shtesë mes dy ekipeve. Të dyja ekipet e mbyllën sezonin e rregullt me pikë të barabarta në Konferencën e Perëndimit, ndaj u desh një vend shtesë për vendin e tetë në këtë Konferencë. Skuadra e Portlandit arriti të triumfojë falë dyshes Lillard-McCollum, që të bashkuar realizuan 60 pikë. Në çerekfinale, skuadra e Blazersit do të luajë ndaj Lakersit.

#### Suarezi mund të rikthehet në Ajax

Barcelona pritet të pësojë shumë ndryshime gjatë merkatos së verës. Së fundmi nga Uruguai ka pasur lajme që e lidhin sulmuesin Luis Suarez me ish-klubin e tij, Ajaxin. Diçka e tillë konfirmohet edhe nga gazetari Oriol Domenech, i cili në "Twitter" shkruan se kjo është e vërtetë. Ai shton se klubi holandez disa javë më parë ia ka shprehur idenë për t'u rikthyer sulmuesit. Jo vetëm kaq, pasi për Luis Suarezin ka edhe një ofertë konkrete dhe ai duhet të vendosë se çfarë do të bëjë. Edhe Inter Miami në MLS interesohet për shërbimet e sulmuesit.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

## Lume's Details

### Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

► Senad Qajani shpalle te pavlefshme Diplomën e Shkollës se mesme Sh.M.L. "Dardania" Hani Elezit.

► Liridonë Selmani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale "7 Shtatori" Prishtinë.

► Bashkim Morina shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Medi Pulaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Heronjtë e Lumes " Vermic.

► Ismail Morina shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Atakan Vermica shpall të pavlefshme dëftesën e kl X shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Krasniqi SH.P.K shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër 330186454, Vushtrri.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.